



E DIEL
28 Maj
2017



e-mail: milosao2005@yahoo.com



Korrespondenca e panjohur e Mitrush Kutelit me Aleks Budën

Dhimitër Pasko - Mitrush Kuteli (1907-1967) nuk je toj edhe më gjatë. Tronditja që pësoi me persekutimin e sekuestrimin e dorëshkrimeve të veta nga regjimi i pushtetit monist, që në vitet e para të vendosjes së tij, e rëndoi. Kujtoj kur unë fare e re, së bashku me tim atë, Aleks Budën, jam ndodhur në një takim në rrugë me shokun e tij të hershëm, Dhimitrin, pasi kishte dalë nga burgu. Dhimitri tregoi për shqetësimet e tij shëndetësore, sidomos për zemrën që e kishte të çfilitur, duke nxjerrë nga xhepi i vogël të xhakëtës dy trinitrina që i mbante vazhdimisht me vete.

Por më shqetësuese se kjo gjendje e shëndetit të përkeqësuar ishin shqetësimet për dorëshkrimet që i mungonin. Nëse nuk gaboj bëhej fjalë për rreth 200 faqe të sekuestruara nga një hetues, person me gradë ushtarake, që ishte marrë me çështjen e tij në parburgim. Ishin dorëshkrime që duheshin gjetur dhe që s'u gjetën më. Ato kishin dalë nga Ministria e Brendshme. Kaq kishin qenë njohuritë e Aleksit në atë kohë edhe

më vonë kur mësoi se më kishte rënë në dorë për redaktim libri i Mitrush Kutelit: "Në një cep të Ilirisë së poshtme" (1983). Një vepër postume e autorit, e përgatitur nën kujdesin e përkorë të të bijave, për të cilën im atë duke e ndjerë si një detyrë nderi e vlerësimi për mikun e vjetër, i kërkoi drejtorisë së Shtëpisë Botuese, t'i bënte parathënien, kërkesë që nuk u pranua. Ruhen ende shënimet përgatitore të Aleksit

për veprën!

Mitrush Kuteli dallohet për një aktivitet të pasur botimesh origjinale me vlera të shënuara artistike si ai që arriti në mbarim të Luftës II Botërore, ndonëse vazhdoi të shkruante edhe më vonë, por në një klimë të pafavorshme. Me prozëmizim genuin poetik të rrallë e gjuhë të pasur, të mbështetura fort në truallin shqiptar,

*"Jeta qoftë dhe e gjatë, përherë do të jetë e shkurtër
Tepër e shkurtër,
që asaj të mund t'i shtohet diçka"*
W. Szymborska

përshkuar nga ndjenjat e thella të lartësimit të kombësisë si fuqi krijuese e kulturës njerëzore e kombëtare në veçanti, veti që e kanë karakterizuar krijimtarinë e tij, Kuteli është një nga theme-luesit e prozës moderne shqiptare. Nëntë letra, të shkruara prej Mitrushit, dërguar Aleks Budës, të ruajtura në arkivin e këtij të fundit, i përkasin pikërisht kësaj periudhe të dendur botimi. Nga letrat, vetëm dy janë të vitit 1936, të tjerat i përkasin vitit 1944. Për hir të së vërtetës duhet pohuar se ato janë ruajtur shumë më mirë se korrespondencat e Aleksit me Lasgushin, Çabejn, Arshi Pipën etj., pjesërisht të dëmtuara prej rrethanash vendore.

→

Vijon në faqen 16

Në këtë numër: Aleks Buda dhe Mitrush Kuteli sjellë nga Dr. Tatjana Haxhimihali; Numri Zero i Eco; Bashkim Shehu me shkrimin e Bernardo Atxaga, Arian Leka botohet në Berlin; poezi të Jasna Dimitrijeviç; tregime të Haifa Al Sanousi sjellë nga Kujtim Morina; Dr. Valbona Nathanaili për Ruchir Sharma...

E

EPISTOLAR

"Milosao" ka fatin që në këtë numër të botojë një epistolar të dy figurave të mëdha të historisë dhe letërsisë shqiptare. Por Buda dhe Kuteli, të dy sëbashku, mbeten emra të qashtë sa i përket moralit studimor dhe përpjekjes së tyre për të bërë më të mirën për vendin e tyre. Konsiderata jonë shkon edhe për të bijën e prof. Budës, që na e ka besuar këtë epistolar...

Mbi një korrespondencë të panjohur të Mitrush Kutelit me Aleks Budën

Vijon nga faqja 15

Së bashku "me urimet më të përzemërta për një vit më të kthjellët" (më 4 janar 1944), Mitrush do t'i shkruante Leks Budës: "Nuk munda të vi në Elbasan nga shkaku i rrethanave, nga se një kohë të gjatë kam qenë i robëruar prej punës në lidhje me disa tratativa prozaike shqiptaro gjermane për një konventë ekonomike... Po të dërgoj librin e rrëfimeve, librin e vjershave të Nolit pakëz më von, se nuk është lidhur"... Dhe po aty: "Kam nënë shtyp 1. *Shënime letrare 2. Netë shqipëtare (bot. II)*. Kam gati për shtyp 1. *Këngë e brithma nga qyteti i djegur (folklor i mbledhur në Pogradec)*. Në përgatitje 1. *Një vëllim rrëfimesh e rrëfimesh (i mbaruar afro 50%)*. 2. *Një edicion të veprës së Migjenit (vjersha e prozë)*. Nëpërret e kokës 1. *Çajupin 2. Një vëllim me...vjersha (Poem kosovar, Shëndaumi e disa të tjera inedite)*...E këndove *Poemin kosovare dhe Letrën e Shëndaumit*? Janë të shkuara nëpër shpirt. Jep-më mendimet e tua mbi rrëfimet, haptazi, si shok." Sa shumë plane dhe të realizuara, po të realizuara mjeshërisht. Një seleksionuese e pashmangshme dhe e pamëshirshme si koha i ka çmuar lart, ashtu siç ndodh me vepra artistike përfaqësuese në thesarin kombëtar edhe kur u përkasin periudhave kohore e brezave të tjerë.

Jam e mendimi se jo vetëm rrethana lidhesh fisnore me familjen e Paskove, (kushërira e parë e Aleksit ishte martuar aty), e as vetëm adhurimi për qytetin romanik të Pogradecit të hyznizuar prej bijve të tij të shquar në veprat e tyre, nuk do të kishin krijuar marrëdhënie të tilla besimi e mirëkuptimi si ato që shprehen në këtë korrespondencë. Në letërën që Mitrush i ka dërguar Aleksit në Vjenë (6 tetor 1936) shkruante:

"Mik i dashur,

Të dërgoj të fala miqësore nga Bukureshti im vjeshtak ku arrijta përpara disa ditë. Këtu më fort se në Pogradec, e ndje nostalgjinë e djellit të ëmbël të Shqipërisë së Mesme, i cili më pat mbushur plot shpirtin në muajin e kaluar. Me këtë mall po filloj punën...duke u menduar për t'u këthyerë prapë e për të vepëruar në fushat e gjëra të vendit lindor, ku lipset krijuar një botë e tërë. E kam, i dashur Leks, edhe të gjallë ushëtimën e bisedimeve t'ona përmi revistë letrare dhe sociale ("Veprimi" ose si do të quhet) të cilën e ke projektuar t'a nxjerrësh në Shqipëri të dhe miqtë e tjerë të gjith atij mendimi". Të uroj edhe që prej së largu

sukses të plotë dhe pres ftesën për bashkëpunim në numrin e parë.

Përpara disa ditë të dërgova disa libra nga të mijat, të cilat nuk munda t'i jap kur gjendesha në Shqipëri. Së shpejti do të të dërgoj edhe disa të tjera. Mos harro, të lutem, të më shkruash kur të nisesh për në Shqipëri. Me të fala të këthjellta,

Dhimitri P. Pasko"

Është ajo afëri shpirtërore njerëzish, me mendime e qëllime të ngjashme në radhë të parë, që do ta bënte të pëlqyer edhe shtëpinë e Budave në Elbasan, ku venin për të kaluar disa ditë, sipas rastit, Lasgushi, Mitrush, Tashkot, Cancoja i librarisë, Qemal Butka, Skënder Luarasi, Inxh. Lufi etj. Shpesh në një



Aleks Buda

atmosferë bisedash e diskutimesh letraro-filozofike, që ata vetë e patën vlerësuar si vendin ku "Les grands esprits se rencontrent".

Në letërën dërguar Leks Budës nga Bukureshti, (më 4 Nëntor 1936) Mitrush Kuteli bën një rezimë të aktivitetit të tij studimor në kryeqytetin e Rumanisë, ku kreu studimet e larta, duke komentuar një "shkrim studentije" që më së pari e botoi në një gazetë të atjeshme, pastaj hartimin e "një pjese libe për Bankat bujqësore të Ballkanit". "fryt i një mendimi më të pjekur" dhe më tej kumton se është duke e dërguar në shtyp librin për "doktrinarin më të famshëm të nacionalizmit dhe antisemitizmit në Rumanitë". Z. A. K. Kuza, profesor në Universitet dhe antar i Akademisë rumune. Interesant është fakti se edhe larg Shqipërisë edhe se merrej me probleme që lidheshin me çështje ekonomike, të specialitetit që studio, ai ka qenë në korrent të vazhdueshmë me jetën letrare dhe publistikë shqiptare. Përgatitje me seriozitetin e karakterizonte, siç

"Jeta qoftë dhe e gjatë, përherë do të jetë e shkurtër
Tepër e shkurtër,
që asaj të mund t'i shtohet diçka"

W. Szyborska

duket edhe në këto shkrime, nga kërkesat që i vë vetes, për të qenë edhe pjesëmarrës aktiv në letërsinë shqipe: "dëshiroj të përgatit e të vë në shtyp një libër të cilën do ta quaj "NETË SHQIPTARE", ku do të përmbledh disa nga rrëfimet që kam bërë kur isha më i ri". Citojmë vetëm fillimin e letrës, ku vërehet se çështjet që lidhen me Shqipërimë janë në rend të parë, në faqen e parë dhe më tej ato që u përkasin detyrave të tij të domosdoshme, të ditës, në

që jeton në katundet e pashkelura prej Brankos. Dyke mos e njojtur këtë njeri, në kompleksin e tij jetor; Brankoja nuk munt t'i shërojë plagët. Sepse shërimi lyp, herën e parë, njojtjen e konstitucionit, shumë herë në mënyrë historike, lyp pastaj diagnostikimin e të sëmurit e kështu më tej. Ç' bën Brankoja? Lëçit një libër, dy libra, njëzet libra teorike përmbi socjologji dhe kërkon t'ja aplikojë jetës shqiptare. Po libra e shkrojtur prej

ose me shkrim. Nga një letër e M. Kutelit që në krye mban shenjat "Banka Kombëtare e Shqipërisë - Zyra e Konsulentit teknik" (Tiranë, 8 Janar 1944) shkëpusim një pjesë që lidhet me ndjeshmërinë e skrupulozitetin karakteristik të shkrimtarit:

"I dashur Leks,

Të faleminderit fort për kujdesin që tregon për librat e miya. Unë nuk të pata dhënë hollësisht mbi konditat e shitjes, mbasi këto janë të dorës së dytë dhe i le në vendimin t'ënd të plotë...Pres të më dërgosh edhe gjykimin tënd objektiva, pa kontingenca miqësije, mbi përmbajtjen e tyre.

E di unë vetë se jam tepër lokalist, aqë nga përmbajtja e themave sa edhe nga gjuha, po ç' të bëj, s'kam se qysh të shpëtoj nga vetë vetja, e cila është, si e di ti vetë, prej natyre subjektive, e mbase tepër subjektive.

Si do qoftë njerëzit që hyjnë e dalin në rrëfimet nuk janë krijuar ex-nihilo, po të marrë nga jeta e gjallë me ndryshimet që i imponzon arti për shdukjen e trajtave brute, pra të parë pak si lark.

Do të lutesha përsëri (a ma fal këtë?) për përkthimin gjermanisht që pate filluar dhe për të cilin në qoftë se nuk gjen në dy librat lëndë të plotë mund të të jap disa dorëshkrime nga volumi i tretë që kam në përgatitje dhe i cili gjer tani s'ka embër. Po për këtë e shumë të tjera, që nga nevojja për konsultimin e disa librave rumanisht të bibliotekës së atyshme e gjer në shqyrtimi i do një gur varri për plotësimin e koleksionit tim makabr- dhe përmbi të gjitha: për të shkëmbyer së bashku disa mendime e gjykime dua të vij një ditë në Elbasan, ku dhe detyra që kam pranë Bankës më kërkon këtë.

Me dashuri

Yti

Firma - M. Kuteli
Mos harro t'i japësh shumë të fala Zonjes.

Si të duket një bashkëpunim në revistën "Jeta Kristiane" me disa çështje të një qëndrimi të një niveli më të lartë? Unë fillova të shkruaj gjësend në numrin e kaluar edhe në këtë të ardhmen në lidhje me folklorin pogradecar mi këngët e Pashkëve, të cilat nuk janë asfare të shëmtuara as nga trajta as nga përmbajtja. Edhe mi këtë çështje duhet të bisedojmë".

Me sa duket Dhimitri i ka qëndruar fare pak në Elbasan, se pas një muaji (tetor e dt. 24 shkurt 1944) ai shkruante:

"Bëra keq se nuk qëndrova aty atë natë (si tha edhe Qemali) po bëra edhe mirë nga shkaku i insonisë. Këtë ti mund ta gjykosësh nga shpe-



Mitrush Kuteli

Bukuresht, siç i përmendëm më lart.

"I dashur shok,

Këto ditë e fundit e mora letrën t'ende dhe të falenderoj për lajmet e reja që më jep nga Shqipëria. Revistën e Brankos nuk e kam marrë ende...Me gjithë se po shpreh një mendim të nxituar, sepse nuk e kam lëçitur, me gjithë këto dyke njojtur pak a shumë Brankon pas disa shkrime të vjetër më duket se revista e tij nuk është ajo që i duhet kombit shqiptar. Herën e parë Brankoja nuk e njeh as shqipen as shqipëtarin. Të flas për shqipen e vërtetë dhe shqipëtarin e vërtetë. Shqipja e vërtetë është gjuha e folklorit - e këngëve, e përallavet, e legendave - të cilat nuk lëçiten as nuk mësohen po dëgjojen pranë vatrës, ndjehen prej shpirtit, bëhen element...Këtë element nuk e ka Merxhani. Pastaj, shqipëtarin e vërtetë, krijesë e shekujve dhe e tokës që banon, nuk është vetëm katundari i parë në tregun e Tiranës, po një tjetër njeri: ay që përshkruan këngëtori popullor; ay

një gjermani ose prej një francezi, qoftë edhe profesor universiteti, nuk i përshtatet fort realitetëve shoqërorë shqiptarë, të cilat janë rezultat i një evolucioni të gjatë...Fatkeqërisht Brankoja punon me kallëpe, si shtrati i Prokurustit...

Po, unë jam i mendimit t'a lemë Brankon në rrugën e abstrakcioneve. Sa për ne, ne nuk kemi tjetër udhë përveç se udhën e realitetëve. Shenkenca do na shërbejë si *metudhë* për të njojtur këto realitete. Qysh? Si pas fjalëve të Lasgushit "me yll në ballë e me zjarr në gj", domethënë: me dritën e shkencës e me zjarrin, me dashurinë e shpirtit. E pres me brohoritje këtë ditë, të cilën ti me shokët e tjerë po përpigji t'a sillni..."

Mbaj mend nga im atë, Aleks, se në diskutimet e tyre, Mitrushit i pëlqente shumë mendimi i De Saussure se fjalët kanë vlerë si kartëmonedhat. Se të jesh pronar i një fjale do të thotë të kesh besim që ajo e transmeton drejt kuptimin e vet në procesin e komunikimit me gojë

B

BOTIM

NGA BEN ANDONI

A nkthi i përgatitjes së një pe riodiku të përditshëm ka ngulfatur një nukël njerëzish, që nuk kanë aq shumë lidhje me gazetarinë. Doktor Kolona, personazhi që prezantohet nga bos i tij, si njeri me përvojë të madhe në gazetari duhet të mbulojë gabimet e kolegëve por edhe vështirësitë e stilit dhe ndikimet e tyre deri më tani. Ngjarjet zhvillohen në një redaksi mediatike e cila përgatitet të nxjerrë një numër (Numrin zero), që nuk do ta shohë kurrë dritën e botimit. Në formën e një ditari paraqitet aksioni, që narratori i veprës e rrefën në vetën e parë me shumë kujdes brenda diagramës jetësore të personazhit. Romani i afrohet shumë kohës sonë, më mirë të themi epokës ku jetojmë, pasi në vendin fqinj (Itali) rrotullohen ngjarje tragjike siç janë vrasja e gjykatësit Falkone, momenti kur po vjen lulëzimi i Antonio di Petros dhe shumë toll-ovi të tjera. “Nesër” siç do të njihet organi mediatik dhe që duhet të bjerë me patjetër në sy duhet të përshatë sa më mirë hamendësimet, që të mbijetojë sipas organizatorëve të saj, por duhet të përdorë paq edhe shantazhin dhe shumë gjëra të tjera. Në një farë mënyrë i ngjan një trilli virtual mediatik, që pjell vetëm gënjeshtra.

Autori me stilin e tij të jashtëzakonshëm e ka mbajtur me kadençën e duhur ritmin dhe për të gjetur detajin që do të grishë për linjën e veprës së vet. Ledia duhet

“Numri zero” e përzien sarkazmën, stigmën dhe paradoksin, që është aq i zakonshëm në veprën e Ecco-s me një ligjërim gati linear. Por ne duhet të bëjmë atë që bën një lexues për të perceptuar atë që imagjinata shkon me të vërtetën dhe autori të shoqëron edhe vetë që ti ta kuptosh sa më mirë. “Asgjë nuk mund të na tronditë më në këtë vend. Në fund të fundit, kemi parë pushtimet barbare, grabitjen e Romës, masakrën e Seniglias”, e mbyll ai...

“Numri zero”, si ironi dhe trandje për gazetarinë



shqiptar.

Po çdo të bëjë vallë i ashtuquajtur i numri zero? Për pronarin ai duhet të trandë dhe fillimisht duhet të ç'tensionojë atë që vjen mes parisë dhe atyre që do duhet të përcjellin lajmin.

Në këtë institucion të ri, por që në thelb është çdo organ mediatik i kohës ku po jetojmë përgatitet shantazhi dhe gjithçka duhet që ta bëjë sa më të kënaqur pronarin. Teoritë e konspiracionit, që e rrethojnë Italinë dhe fantazinë e sëmurë të shumë personazheve (lexo shumicën e njerëzve tanë), ndërthurën dhe japin atë që duhet të mbahet sa më qartë në qendër të medias.

Redaktori Bragadaço, që autori shpesh e përdor si kundrapeshë të qëndrimeve të veta, jep vazhdimisht idera që e tejkalojnë mendjen e zakonshme duke dhuruar zgjidhje nga më të habitshmet, pasi në fantazinë e tij përfshijnë rëndom rusët, shërbimet sekrete, patjetër Andreotin e me radhë politikantët e kohës dhe mbi të gjitha Musolinin. Këtë të fundit e hasi duke. Arketipi i këtij gazetari përbën një personazh tipik të mediave provinciale që kërkujnë me fantazinë e tyre të çmeritur të tërheqin dhe të tjerët në një vale të frikshme.



Titulli: “Numri Zero”
Autor: Umberto Eco
Botimet: “Dituria”
Përkthyes: Ledia Dushi
Çmimi: 1.000 Lekë
Faqe: 207

Në një farë mënyrë ky libër është edhe një traktat kundër gazetarisë së keqe, që autori e mbulon me gjuhën e romanit, ku për t'i dhënë liri stilit përzien me të gjithë detajet e informacionit duke përfshirë horoskopin, nekrologjitë dhe parashikimin e motit (jo vetëm atmosferik: “Çështja e celularëve nuk mund të zgjasë”, shkruan një gazetari i viteve '90). Edhe pse historia e paraqitur në libër është një histori që i qëndron disi larg në dukje Shqipërisë, botimi afrohet shumë në perceptim me kaosin

tonë mediatik, pasi shpalo të vërteta universale. “Gazetat i mësojnë njerëzit sesi duhet të mendojnë”.

Dhe kjo është edhe më interesante ende: “A duhet të flasim patjetër gjithnjë për profesionalizëm? ndërhyri Maja. Këtu që të gjithë punojnë me profesionalizëm. Natyrisht, një kryemjeshër që ngre një mur që nuk bie, do të thotë se ka punuar me profesionalizëm. Por atëherë profesionalizmi duhet të jetë pikërisht rregulli. Ndaj duhet të flasim vetëm për kryemjeshtrin faqezi, muri i të cilit bie...”. “Pikërisht, thashë unë duke e marrë sërish fjalën, lexuesit mendojnë sesi rregull njerëzit punojnë shkel e shko dhe ne duhet të nxjerrim rastet e profesionalizmit, është një mënyrë më teknike për të thënë se gjithçka shoi si duhet...”.

Libri e përzien këndshëm sarkazmën, stigmën dhe paradoksin, që është aq i zakonshëm në veprën e tij, me një ligjërim gati linear. Por ne duhet të bëjmë atë që bën një lexues për të perceptuar atë që imagjinata shkon me të vërtetën dhe autori të shoqëron edhe vetë që ti ta kuptosh sa më mirë. “Asgjë nuk mund të na tronditë më në këtë vend. Në fund të fundit, kemi parë pushtimet barbare, grabitjen e Romës, masakrën e Seniglias”, e mbyll dikë. Në fakt autori e mbyll shumë mirë në një dashuri, me anë të cilës na fut në rrjedhë normale të jetës sonë të zakonshme. “Jeta është e durueshme, mjafton të jesh i kënaqur”, na thotë autori ardhur me një punë të mirë të Ledia Dushit e sprovuar edhe në një përkthim tjetër nga Eco. Ky i fundit ardhur gati me të gjithë korpusin e tij, falë “Diturisë”.

jtësia qysh t'i kthe librat (pjesërisht e krijuar nga dëshira për të shkuar nëpër duar, të gjitha në një kohë...këto libra-miq të vjetër).

Harrova të marr dije atë numrin e Përpjekjes së fundit. Mbetet për tjetër herë...

Nuk di kur do të kthehem në “Qytetin e filologëve” (Kristoforidhi, Xhuvani, Koleja, Nosi, Buda...—a ka më? Po do kthehem. Në mos u sëmërua nga morbi i fjalorëve—as që mund se nuk jam tip logjik—gjith kam për të kopjuar nga një shkrim nga gurrat e varreve, qofshin turq, qofshin kaurë...Unë mbrëmë edhe sot në mëngjes shkova nëpër duar disa numra të Përpjekjes edhe të Illyrisë duke prerë me gërshtë shkrimet e Vangjel Koçës, nga të cilat dëshiroj të zgjedh gjësend për rishitje. Më vjen keq se prishet koleksioni, po ndryshe qysh të bëj?...”

Është vënë në dukje nga kritika letrare se si në një situatë aktuale të trazuar, gjatë Luftës II Botërore, lëvizja letrare në Shqipëri u gjallërua. Një reaktion kundrejt gjendjes së amull në kondita pushtimi, apo dënduri krijimesh si pasojë e heshtjes që kishte karakterizuar shtypin shqiptar pas pushtimit fashist italian? Cilado qoftë arsyeja që e shpjegojnë teoricienët e letërsisë është fakt, siç duket edhe nga kjo korrespondencë, ku pothuajse nuk është përmendur lufta, se arti dhe letërsia kanë ligjet e tyre të veçanta. Në letërnë e dt. 5 mars 1944

Mitrushit do të shkruante:

“Si t'u duk numri 2 i Revistës Letrare?”

A do mundësitë të na japësh edhe ti gjësend (me emër a pa emër)? Bie fjalat gjësend nga ato “ballkanizmat” e tua?...E pe “Frymën”? Pak si e rëndë më duket. Recenzioni që doli sot mbi “Ago Jakupin” është shkrimi i fundit i një mësuesi- të cilin unë s'e pata njohur- ky Dode vdiq papritur në Berat. Premtonte të dalë një analist i mirë, thellonjësi i problemave letrare!?

edhe shoqërore. Observacionet e tija janë me vënt e me mënt. Për fat të keq djaloshi s'është më...”

Letrat që pasojnë janë më të shkurtura (një faqe formati të zakonshëm), të shkruara si edhe të tjerat, kryesisht me makinën daktilografike personale dhe rrallëherë me dorë. Një muaj më vonë (dt. 4 prill 1944) një letër falënderimi i Mitrushit i dërguar Leks Budës, për cekun e librave të para që ky i kish dërguar nga Elbasani si dhe për librat e huazuara nga Biblioteka e Aleksit dhe e Elbasanit. Me dëshirën e përsëritur “të vij aty për disa ditë në këtë prenvërë që vjen e s'vjen dot (të pak tën kështu duket në Tiranë). Nuk di kur do mund. Më mirë për të thënë: nuk di kur do të mund të shkëputem nga kjo prozë e Tiranës ku zhgry-

hem ditë e natë...Po të dërgoj këtu libër time të re “SULM E LOTË”, të cilën do ta venë librarit këto ditë...”

Shënim: Shpresoj se do të nxjerr së shpejti vullmin “Shënime letrare” që e kam vënë në shtyp, sikundër se e di, që në nëntorin e kaluar. Për vullmin që kam gati për shtyp “Kapllan Aga i Shaban Shpatës” po përpiqem e s'gje dot shtypshkronjën. Po na mbyl monopolin i tregtarëve të kartës edhe i tregtarëve të mellanit.”

Pothuajse në të gjithë këtë korrespondencë ndihet si një jehonë e trishtuar shqetësimi i vazhdueshëm i Mitrushit për sigurimin e letërës dhe të hollave për pagesën e shtypshkronjave ku i duhej të botonte librat (“Hej Shqipëri, hej”, “Ah, sikur të kishim një shtypshkronjë!”). Fakt është se të gjitha veprat e Mitrushit kuletit të botuara në këtë periudhë, të ruajtura² edhe sot në perlat e pakta të ish-bibliotekës së Aleksit, janë fare modeste nga paraqitja. Më se domethënës është paraqitja e librit të fundit të këtij vargu: “Dashuria e barbarit Artan dhe e të bukurës Galatea” (1946) që ka dalë nga shtypi i pambaruar. Pranëvëndi është me “daktiloshkrim” përfundim i tregimit të fundit që mbyll fashikujt e shtypshkronjës të qepura me dorë. Tregim, i cili do të jetë temë e një shkrimi tjetër për Mitrushin Kuteilin. Por ka ardhur koha të themi ne: Ah, sikur të rronte Mitrushit të gjente të plotësuar ëndrrën e tij!

Veprën e plotë të përgatitur me dashurinë e madhe që ia kthejnë të bijtë, “rebelët” e tij, së bashku me mirënjohjen e shprehur prej atyre që ndihmuan botimin e saj. Duke arritur të realizojnë botime të shkëlqyera nga të gjitha drejtimit në shtypshkronjën me emrin domethënës **Grand print**.

Dr. Shk. Tatjana Haxhimihali

¹ Shënime
² Ka qenë një ide e Aleks Budës, Skënder Luarasi dhe Arshi Pipës për të botuar së bashku një revistë letraro-artistike. Ideja realizohet vetëm në vitin 1945 kur del e përmuajshmia Kulturore “Bota e Re” me redaktim e përbërë nga A. Buda, N. Haku, M. Kuteilit, S. Luarasi, Sh. Musaraj, A. Pipa, Z. Sako, Dh. Shuteriqi, S. Toto, A. Varfi.

³ Shpirtat e mëdhenj takohen.
⁴ Të dy miqtë ishin marrë vesh që shpërndarjen e librave të Mitrushit në Elbasan ta bënte një librarshitës, punën e të cilit e ndiqte Aleksit.


⁵ Aleksit pati përgatitur përkthimin në gjermanisht të disa regjimeve të M. Kuteilit për prof. Valjavecin, i cili është marrë me çështje të albanologjisë në Institutin e Evropës Juglindore në Gjermani në fillim të Luftës II Botërore.

⁶ Ky mendim është shprehur edhe në M. Kuteilit: “Shënime letrare”, Sht. Bot. “Grand Print”, T. 2007, (Gjeografia letrare) fq. 423.

⁷ Kanë qenë sekretarë meskeda të mbledhura nga letërsia dhe folklori ballkanik ku evidentoheshin fjalë të shqipes në konkordancë me gjuhët ballkanike, që do të shërbenin për përgatitjen e një teme, e cila do t'i jepte Aleksit vendin e lektorit të shqipes pranë Prof. C. Tagliavinit në Universitetin e Padovës, por që u ndërpre për shkak të luftës së dytë botërore.

⁸ Mendim i shprehur edhe në “Shënime letrare”, Sht. Bot. “Grand Print”, T. 2007, (Ago Jakupi), fq. 471.

⁹ Në secilin libër është shkruar me kaligrafi dedikimi: “Leksit me dashuri- m. Kuteilit”, vetëm njëri (“Këngë e britma nga qyteti i djegur”) ka shënimin: “Leksit me dashuri- këto duaj lulesh mali”.



T

TREGIM

Letërsia e vendeve arabe vjen në pak raste si këtë herë tek "Milosao" në një përkthim të kujdesshëm të Kujtim Morinës, që duhet vlerësuar për zgjedhjen e tij. Kjo sepse ti më shumë sesa propaganda e ditës kupton funksionimin e brendshëm të këtyre vendeve përmes përshkrimit letrar. Dhe, cila fushë më mirë se letërsia mund ta bëjë këtë...

NGA HAIFAAL SANOUSI

"Artikulli i parë që shkrove më bëri të ndihsha sikur isha përballë një shkrimtare të madhe" i tha njëri.

"Faleminderit" tha ajo me një buzëqeshje të madhe në fytyrë.

Ajo ishte shumë e lumtur atë ditë megjithëse nuk kishte planifikuar të ndiqte konferencën sepse kishte dhimbje koke. Një prej kolegëve të saj e kishte nxitur për të marrë pjesë.

"A mund të na thoni çfarë do të thotë për ju gazeta 'Al Vatan'?"

"Është jeta ime, e gjithë jeta ime" u përgjigj ajo me krenari. "Gazetat janë të pazëvendësueshme për mua; ato janë si ajri që marr frymë; do të vdisja nëse nuk mund të shkruaja artikullin tim të përditshëm" shtoi ajo me entuziazëm.

"Çfarë interesash keni përvetë punës?"

"Të lexuarit do të thotë gjithçka për mua. Libri është burimi im për të zbuluar botën përreth. Ai është një mjet për t'ia zgjatur jetën çdo gjëje të vlefshme. Libri është elementi i ruajtjes, përcjelljes së eksperiencës, vëzhgimeve, dhe shprehjeve krijuese në një vlerë të qëndrueshme. Kam qenë e dhënë keq pas librave qëkur isha fëmijë. Kam qejf t'ju dhuroj libra, të njohurve. E kaloj kohën e lirë duke lexuar libra me tematikë të ndryshme. Gjithashtu eci buzë detit tre herë në javë. E ndjej detin si burim të frymëzimit për shumicën e ideve të mia."

"Po për familjen tuaj, a...?"

Ajo e ndërpreu pyetjen që i sillte ankth përpara se ta pyesnin për burrin dhe fëmijët "Pse erdha këtu. E dija se do të ma bënin këtë pyetje" u mendonte ajo.

"Mirë, mendoj se duhet të shkoj tani sepse po bëhet më shumë se një orë intervistë. Ju falënderoj singjerisht për ftesën në universitet dhe pres me padurim t'ju shoh përsëri në të ardhmen."

Ajo u përpoq t'i jepte fund takimit me studentët e profesor Faisal që e kishte ftuar atë në këtë takim të hapur me më shumë se njëqind studentë të kursit të gazetarisë.

"Dëshirojmë të falënderojmë znj. Loulha Jassem, gazetare e mirënjohur dhe autore e rubrikës ditore "Zonë e nxehtë" të së përditshmes "Al Vatan". Shpresojmë se ka mbetur e kënaqur nga ky takim me sot". Profesor Faisal buzëqeshi dhe i bëri shenjë njërit nga studentët që i sollti asaj një buqetë të mrekullueshme me lule dhe një student tjetër që i dha një certifikatë mirënjohje.

Loulha i falënderoi ata përsëri për mikpritjen dhe falënderoi gjithashtu profesor Faisal për ftesën. Ndërsa po përgatitej të lar-



CILA ËSHTË HAIFA AL SANOUSI

Haifa Al Sanousi është një shkrimtare kuvajjtane. Ka kryer doktoraturën për letërsi moderne arabe dhe kritikë në Universitetin e Gilasgout në Skoci, Mbretëri e Bashkuar. Aktualisht punon si Profesore e Asociuar për gjuhë dhe letërsi arabe në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Kuvajtit. Ka botuar një përmbledhje me tregime të shkurtra në anglisht të titulluar "Gratë në një shtjellë" (Women in a Swirl) dhe dy përmbledhje të tjera në arabisht përkatësisht "Zhurma" dhe "Ika e detit". Ka botuar gjithashtu një libër me proza poetike në anglisht të titulluar "Momenti i heshtjes" (The Moment of Silence). Haifa është anëtare e Shoqatës së Shkrimtarëve të Kuvajtit dhe asaj të Mbretërisë së Bashkuar.

Të kërkosh për asgjë

gohej, studentët u afruan t'i bënin fotografi dhe i kërkuan t'ju nënshkruante autografe. Sytë e saj nxorën shkëndija nga lumturia dhe entuziazmi për të shkruar në rubrikën e saj për këtë eveniment.

Ajo u largua me nxitim nga salla për të shkruar në ambjentet e gazetës për t'i dorëzuar redaktorit artikullin që ajo e kishte shkruar ditën e mëparshme. Shikoi orën.

"Oh, është ora një tashmë, duhet të shkoj në shtëpi sepse mbesa ime do të vijë për drekë sot. Ajo do të jetë aty brenda disa minutash"

veten. "Po për familjen tuaj, a...?" Kjo ishte njëra nga pyetjet që iu duk si një gjemb i ngulur në zemër. Pse duhej domosdo të ishte e martuar!! Pse nuk e kuptonin ata se ajo ishte ende beqare? Ajo ishte afërsisht 45 vjeçe dhe ende beqare. Ky ishte fati i saj dhe ajo s'mund t'i shmangej. Ajo do të donte të ishte martuar dhe shtëpia e saj të ishte plot me fëmijë por ky ishte një mirazh tani; ajo ishte viktimë e destinimit të saj.

Ora po shkonte 2 mbasditë dhe nuk dukej shenjë se Hendi po vinte. "Nuk e di pse ajo po vonohet, ajo është e rregullt gjithnjë në orare" mendonte.

njerka që e urrente atë dhe merrej me të si me një vajzë të dorës së dytë. Babai i saj kishte një personalitet të paqëndrueshëm që nuk mund t'i rezistonte ligësisë së gruas së tij. Ai kurrë nuk arriti të mbroste fëmijën e tij.

Ajo ishte larguar nga shtëpia e babait të saj për të shkruar të jetonte me vëllain e saj më të madh Nauaf që ishte dhjetë vjet më i madh. Kjo lëvizje kishte qenë e detyruar pas vdekjes së babait të saj. Nuk ishte shumë e mirëpritur as në banesën e re. Nauaf nuk ishte i kënaqur me këtë gjendje sepse ai e dinte se gruaja e tij nuk e donte Loulhan aty, megjithëse



Ajo nxitoi për në shtëpi dhe Liza, shërbëtorja, i dha asaj listën me njerëzit që e kishin telefonuar.

"A thirrri mbesa?" pyeti ajo në ankth.

"Jo, mam, nuk mori." u përgjigj shërbëtorja, "Kam gatuar gjellë të shijshme dhe sallata do të jetë gati tani"

"Faleminderit Liza. Mos harro të bësh ca lëng të freskët portokalli. E di se Hendi i pëlqen lëngjet e freskëta"

"Po, mam" u përgjigj Liza.

Loulha shkoi në dhomën e gjumit ndërsa ndjente paksa marrje mendsh. Kishte nevojë të clodhej për disa minuta për ta marrë

Loulha kujtoi artikullin që do të botohej ditën tjetër. Ishte për ndjenjat e brendshme të njerëzve. Ajo kishte pasqyruar edhe ndjenjat e saj të brendshme gjithashtu. Ajo do të donte që dikush të kishte qenë në dëgjim të flakës në kraharrin e saj të shkaktuar nga vetmia. Endërronte gjithnjë që një burrë do të vinte dhe ta çlironte nga vuajtja.

Sollti ndër mend fëmiminë e saj dhe vuajtjet e adoleshencës. Ajo nuk mund të harronte kurrë çfarë i kishte ndodhur në të kaluarën. Fati e kishte vënë atë në një botë brengash dhe trishtimi. Nëna e saj kishte vdekur ditën që ajo kishte lindur. Ajo ishte rritur nga

mbesa dhe nipi i saj Hend dhe Helal ishin shumë të gëzuar të kishin dikë që kujdesej dhe kalonte ca kohë me ta. Të dy ishin nën 10 vjeç ndërsa ajo ishte njëzet, në vitin e dytë të kolegjit. Ajo bënte në shtëpi rolin e tezes së dashur dhe të kujdestares për fëmijët e vëllait. Nëna e tyre e kalonte shumicën e kohës jashtë.

Ajo kujtonte skenën e tmerrshme që e detyroi të largohej përsëri nga shtëpia. Ajo ishte viktimë e gruas së vëllait të saj Fatima, që kërkonte me insistim divorc nëse Loulha nuk largohej menjëherë. Ajo ishte xhelozë me Loulhan sepse ajo ishte shumë e cekët. Ajo ishte dy me trup dhe

një me mendje. Kishte dështuar në shkollë dhe nuk kishte gjetur një punë kështu që bënte me faj Loulhan për kompleksin e saj të inferioritetit, që e kishte tejkaluar për gjithçka.

Loulha kishte ikur nga shtëpia dhe kishte kaluar disa javë me një kushërirë dhe saj përpara se të lëviste në banesën e vet. Ishte e detyruar tani të mbështetej në forcat e veta. Ky ishte largimi i dytë që e la të mbështetë në zemër që nuk do të shërohejshin kurrë. Ajo lidhej rrallë me vëllain e saj Nauaf por Hend dhe Helal pyesnin vazhdimisht për të. Helal ishte martuar dhe kishte udhëtuar për të ndjekur studimet në Universitetin e Haudarit ndërsa Hend u diplomua në Institutin tregtar të Kuvajtit dhe punonte në Bankën Kombëtare.

Ora ishte dy e gjysmë dhe Hendi nuk kishte ardhur akoma. Loulha po bëhej merak për të, "Ok, ku je Hend? Jam vërtet e shqetësuar?"

Ca minuta më vonë Hendi e mori në telefon,

"Hello teze, më vjen me të vërtetë keq. E di se duhet të kisha telefonuar por isha shumë e zënë dhe harrova fare. Kërkoj falje"

"Oh, nuk mund ta besoj që po ta dëgjoj zërin tani. Shyqyr Zotit qenke mirë. Vetëm nxito, jam me të vërtetë e turitur"

"Kam frikë se nuk do të mundem të vij. Nuk kam mbaruar punë akoma. Bosi im thotë se nuk mund të largohemi derisa t'i mbarojmë dosjet kryesore. Më vjen me të vërtetë keq por të premtoj se do të takoj javën tjetër. Kalofsh mirë dhe mirupafshim"

"Mirupafshim Hend, shihemi javën tjetër" Loulha e uli receptorin duke u ndjerë e mërzitur vetëm.

Ajo la dhomën e gjumit dhe shkoi në zyrë ku po shikonte librat e saj, gazetat dhe artikujt por nuk kishte asgjë që ta gjallëronte disi. Po meditonte për hallin e saj. "Kush ka nevojë për mua? Kush mendon për mua? Kam qenë e ndruajtur për të hyrë në lidhje me njeri sepse parandiej që gjithnjë do të më lërë në fund. Ata mendojnë vetëm për veten e tyre. Askush nuk kujdeset për njeri, askush" u mendonte Loulha.

Ajo preku fytyrën e saj dhe u shikua në pasqyrë në tavolinë e saj të zyrës. "Oh, të gjitha rrudhat ulërijnë për moshën time. E kam humbur jetën time duke e kaluar vetëm megjithëse e rrethuar me njëri. Askush s'e di tragjedinë time. Ajo vuri kokën mbi tavolinë dhe filloi të qajë. E gëlltiti bregën e saj, u kthye në shtëpi dhe kërkoi në çantë për tabletat. "Duhet t'i ndaloj këto" u mendonte.

Një ndjenjë e cuditshme paniku e shtyu të kërkonte një takim me terapeutin, ditën tjetër.

E

ESSE

Është hera e tretë në pak vjet që proza e shkrimtarit Arian Leka, zë vend disa prej antologjive europiane. Së pari kjo krijimtari është botuar në "BEST EUROPEAN FICTION", 2011, (London, Illinois). "Vëllezër në brisik" (Brothers of the Blade) titullohet tregimi i përkthyer nga Sara Lynn Smith, përzgjedhur dhe edituar nga shkrimtari Aleksandar Hemon me parathënie nga romancier i irlandez Colum McCann.

Më pas kjo botimet kanë vijuar me antologjinë "Das Hemd" (Leykam) Graz, Austri, 2014, ku Arian Leka botoi "Në kërkim të këmishës së humbur".

Së fundmi sapo është botuar edhe në Gjermani nga edicioni Propyläen "Ullstein Buchverlage Berlin" antologjia letrare me titull "Glückliche Wirkungen".

Ky botim i fundit u publikua falë përzgjedhjes dhe kujdesit të dy emrave të njohur për letërsinë në atë vend: të shkrimtarit, poetit e përkthyesit gjerman Michael

Shkrimtari shqiptar Arian Leka botohet në Berlin. Ky botim i fundit u publikua falë përzgjedhjes dhe kujdesit të dy emrave të njohur për letërsinë në atë vend: të shkrimtarit, poetit e përkthyesit gjerman Michael Krüger; i cili është dhe gjithashtu edhe President i Akademisë Bavareze të Arteve të Bukura si dhe të shkrimtares, përkthyeses dhe kritikes letrare gjermano-kroate Alida Bremer.



në këtë antologji.

Synopsisi i tregimi "Qeli prej letre": Kjo prozë rrëfen jetën e një prifti-përkthyes (Haxhimihali, emri i personazhit), i burgosur në vitet e diktaturës të cilit, gjatë periudhës së burgut i duhet të përkthejë në gjuhët e Europës jo letërsinë më të mirë shqiptare, edhe letërsinë e atyre që i kishte shokë qelis dhe që ishin burgosur për shkak të letërsisë. Ai duhet të përkthente me porosi të shtetit letërsinë zyrtare të realizmit socialist, të atyre që nuk ishin në



njëntën antologji ata që u hap gjoksi nga plumbi në zemër, me të tjerët që gjokset iu shpuan nga vrimat e medaljeve të praruarat? Si do të ndiheshin në të njëjtin libër ata që u lidhën me litarë dhe ata që librat i patën me lidhje speciale dhe të qepur me pe? A duheshin të ishin bashkë në të njëjtin libër, nën të njëjtin kapak? Si mund të ishte titulli i antologjisë? A do i ngante libër një kampi përqendrimi apo kopshtit botanik, të mbushur me lulet utopike? Këto dyshime e shqërojnë vetminë e Haxhimihalit, derisa e dorëzon antologjinë. Mes



Peter Byrne, nën titullin "Non-standard Tales From The Real Europe", shprehet: "Arian Leka na tonidit me rrëfimin e tij, tek na përball me peshën e përgjegjësisë që mund të rëndojë mbi familjen shqiptare. Veçse një barrë e atillë rëndon po aq edhe në një mori vendesh të tjera europiane. Është interesant portretizimi i ndërjerë e anoreksisë nga Hilary Mantel, që vëzhgon një familje britanike në kahun "perëndimor" të Europës, ndërkohë që familja te tregimi i Arian Lekës është e njëjës dhe nënkupton "edukim prindëror", ndërsa në Shqipëri ajo merr kup-

mos na përkasë më ne, por njerëzve të tjerë, atyre që sot po bëhen gati të mësynjë në jetën e tij, duke na flakur në të gjithëve, familjarëve të tij jashtë nga parajsja jonë." Teksa mediton me brisik në dorë mbi fytirën e vëllait të vogël, akti na kthen mbrapsht, në të kaluarën e familjes: "...kudo plagë, vraja, blana, lytha të vegjël, gropëza, të çara e vijëzime sa do të mjaftonte vetëm një kalim i pakujdesshëm brisiku, që fytira të lahej në gjak. Dhe sakaq, fëmijëria, koha e pakthyeshme kur ata ishin të pandarë, i kaloi brenda një çasti. Mes gishtërinjve dhe në hapësirën mes dy plagëve iu fanep një tjetër kohë: koha kur ata llangosnin njëri-tjetrin me bojë këpucësh e me kolinoz në gushë, nën hundë e në faqe për të bërë sa më shpejt burra me mustaqe të sajura..." Historia mbyllet me një shënim që do të shërbente si një epigraf për të gjithë përmbledhjen: "Ne ndryshojmë veten për shkak të të tjerëve, ne paguajmë çmim të lartë vetëm për të qenë së bashku..."

"Në kërkim të këmishës së humbur" - Auf der Suche nach dem verlorenen Hemd.

Kleine Zeitung: "Kjo është një ndërthurje e historisë personale

Shkrimtari Arian Leka botohet në Berlin

"Qeli prej letre", pjesë e antologjisë letrare "Glückliche Wirkungen",

Krüger, i cili është dhe gjithashtu edhe President i Akademisë Bavareze të Arteve të Bukura si dhe të shkrimtares, përkthyeses dhe kritikes letrare gjermano-kroate Alida Bremer.

Titulli i antologjisë është "Glückliche Wirkungen" dhe është shkëputur nga letërkëmbimi i datës 21 Qershor 1798, mes poetit dhe mendimtarit Johan Wolfgang Goethe me poetin tjetër gjerman Friedrich Schiller. Pjesë e antologjisë ku është botuar edhe krijimtaria e Arian Lekës, janë shkrimtarë të njohur dhe të vlerësuar ndërkombëtarisht, si Charles Simic (SHBA), Mircea Cartarescu (Rumani), Jeremy Adler (Britani e Madhe) Stefan Hertmans (Belgjikë), Helene Dorion (Kanada), Serhij Zhadan (Ukrainë), Cécile Wajsbrot (Francë), Colm Tóibín (Irlandë), Gerogj Gospodinov (Bullgari), Peter Schneider (Gjermani), Ivana Sajko (Kroaci), Andrej Nikoladis (Mal i Zi), Karl-Markus Gauß (Austri), Viktor Jerofejev (Rusi), Javier Cercas (Spanjë) etj.

Tregimi Arian Lekës, i cili e hap këtë antologji, titullohet "Qeli prej letre". Në gjuhën gjermane ky tregim është përkthyer nga Zuzana Finger dhe mban titullin "Die Zelle aus Papier". Të dy hartuesit e antologjisë, Alida Bremer dhe Michael Krüger, jo vetëm që kanë përzgjedhur krijimtarinë e autorëve dhe janë kujdesur për botimin, por edhe kanë shkruar për secilin nga krijimet e paraqitura



Arian Leka

burg, por që as të lirë nuk ishin. Letërsinë "e lirë", të përkthyer nga Haxhimihali i burgosur, regjimi i përdorte si propagandë, duke e dërguar madje edhe në Panairat Ndërkombëtarë të Librit në Europë. Pas lirimit, menjëherë pas rënies së regjimit, Haxhimihalit, tashmë të liruar nga qelia, i vjen propozimi për të hartuar dhe përkthyer një antologji letrare, ku shkrimtarëve të dikurshëm, t'i bashkonte autorët e ndaluar ata që nuk e kishin parë kurrë jo dritën e botimit, por as të diellit, shkrimtarë që kishin hyrë në burgje, por jo në ndonjë antologji.

Këtu fillon dilemë e përkthyesit-prift Haxhimihali: A ishte e drejtë të ishin bashkë, në të

ndjenjës së drejtësisë hyjnore të Bibla që kishte studiuar e që rrëfente mbi të ujkun që lodron me qengjin, fëmijë që luan me gjarprin në strolullën e tij dhe luanin dhe demin, që ushqeheshin së bashku me kashtë të artë dhe drejtësisë në një shoqëri, së cilës komunizmi i kishte premtuar Mbretërinë e Qiejve, kur të zhdukeshin klasat dhe lufta mes tyre.

Vlerësime kritike.

Të trija antologjitë ku është botuar krijimtaria e Arian Lekës janë shoqëruar me recensa dhe shënime vlerësuese.

"Vëllezër në brisik" - Brothers of the Blade

timin e "detyrimit fisnor".

Brandon Wicks, shkrimtar dhe studiues letrar, duke shkruar rreth antologjisë "Best European Fiction" në "Art & Literature", nënvijëzon: "Vëllimi përfundon me një tekst të shkurtër, ngarkuar me tension të pabesueshëm, me tregimin elegant "Vëllezër në brisik" i autorit Arian Leka, ku si në një ritual, personazhi është i detyruar rruajë fytin pa qime të të vëllait në ditën që atë do ta bëjnë dhëndër - një çast i vogël domethënës, i ngarkuar me ankth dhe me dëshira sublimë."

Kevin Frazier, kritik dhe shkrimtar, në tekstin botuar në "A Map of Faces", duke parashtruar për lexuesin synopsisin tregimit thekson edhe se "...Në paraqitjen shqiptare, "Vëllezër në brisik" nga Arian Leka, vëllai i madh duhet të rruajë vëllain më të ri në një akt të ndërlikuar përkushtimi dhe keqardhjeje, përkushtimi dhe nëntinguj të dhunshëm dhe që na kujtojnë skenën e të njëjtit rit nga "Benito Cereno" e Herman Melville-it. Vëllai i vogël, një njeri guximtar dhe tërësisht njerëzor, për vite me radhë ka qenë shtylla e familjes, por që tash, kur martohet, i duhet të ndahet prej saj. "Pas gjithë kësaj" - vëllai i madh ngarkohet me dilemën - "...nëse vëllai ynë i vogël nuk do të jetë më babë për ne, cili do të jetë ati ynë i vërtetë? Po unë kush do të jem? Çdo të jemi në të gjithë, babai, motra, nëna dhe unë vetë, kur ai të mos jetë më ky që është? Kur të

të një fëmijë të lindur me këmishë, me historinë e një vendi me zonat e tij më traumatike të tij, si humbja e lirisë themelore, fjala, lëvizja, prona, besimi, ateizmi, kolektivizimi (si ironi e globalizimit primitiv) privatja etj. Sa me fat mund të quhej një fëmijë i rritur në një vend absurd si ky...?"

"Qeli prej Letre" - Die Zelle aus Papier.

Alida Bremer: "A si alfa dhe A si Albania. A është Alfa e kontinentit tonë, ndoshta atje, në rrugën e Otrantos, përpara bregdetit shqiptar të Mesdheut, ku ka pasur kaq shumë histori? A edhe si Antologjia.

Në në gjermanisht e quajmë antologjinë (*Blütenlese*), në latinisht ajo quhet *Florilegium*, në greqisht *Anthologia*, dhe është kjo antologji që mbledh përgjigje për pyetjen mbi imagjinatën për një botë më të mirë. Buqeta me lule e priftit dhe përkthyesit të dikurshëm Haxhimihali nga tregimi i Arian Lekës shënon fillimin e një Ere të Re në Shqipëri - një detyrë e vështirë kjo.

Michael Krüger: "Shqipëria, ky është vendi i shqiptarëve, është një vend i shkundur fuqishëm nga ideologjitë totalitare të shekullit XX. "Si mundi Zoti të lejonte që ne të qeshim dhe të qajmë me të njëjtët lot?" pyet veten Haxhimihali. Lindin pyetjet mbi rolin e fesë, që edhe pa fundit të ideologjive ende nuk kanë gjetur përgjigje."

P

POEZIA

NGA JASNA DIMITRIJEVIC

çka ka dashtë me thanë motra

që kam diçka në flokë
që mundem me ndejt edhe pak
që n' mëngjes i ka hapë sytë e ka pyet për mua
që s'ka ndryshime
që dyshemeja asht e lagun dhe me u kujdesë kur të dal
që me sjellë një këmishë të pastër nate
që po i vjen keq
që kam vathë t'bukur
që mos me e harru çadrën
që vizita është për dhjetë minuta
që mos me ardhë kur s'asht koha për vizita
që me ia shiku kambët
janë ba mavi
s'janë ba mavi
që kemi buzë t'njajta, hundë, vetulla t'njajta
që s'kemi shumë kohë
që s'ka me u zgju
që ka me u zgju
që asht e kënaqun
që ka besu gjithë kohën
që mos me pasë frikë
që ma mirë po dukem me flokë t'shkurta
që me lufu
që mos me heqë dorë
që me e lanë duhanin
që me e skenu pasaportën kur dal jashtë
që ka pritë e ka pritë
e që s'ka me mbërrit
që asht lodhe
që nuk varet prej saj
që kostumi asht n' dollap
që udhëzimi asht në këpucën e majtë
kamba hyn ma lehtë kur futet n' qese
t'plastikës
falemnderit
krejt këto ka mujt me i thanë motra
n' korridorin e spitalit
në mes të telorit
në mes të shiut dhe heshijes
por veç m'ka shikur
m'ka matë e ka ngurru
e unë kam ikë
që krejt këto gjana
me qenë prapë të munduna

çka po dridhet mas murit

frigoriferi i markës *obodin*
flaka e qiriut me e thilthë tymin
robat që thahen
zani i një gruaje kur pyet ku je
ku ke qenë
gishlat e burrit që po e kallë cigaren
e mas saj edhe një ljetër
dridhet heshija e tij
dridhet syri i tij i majtë
dridhet buza e saj e poshtme
dridhet gota e xhamit n'tavolinë
se atij po i k'cen gjuni
e po i k'cen dora e djathtë
e mbase ka me fluturu
nëse e pyet edhe një herë
po ndij se krejt po dridhet
e prapë po flej thuasje është veç
frigoriferi i markës *obodin*

Shkrimtarja pjesëmarrëse në Rezidencën letrare "POETIKA - Tirana in Between" - gjatë muajit Maj 2017 ishte tregimtarja dhe kritikja letrare nga Beogradi, Jasna Dimitrijevic. Gjatë qëndrimit të saj në Tiranë Jasna Dimitrijevic u përfshi në veprimtari dhe lexime publike, dha intervista për mediet dhe u bë pjesë e takimeve me studentët të Universitetit të Arteve. Jasna Dimitrijevic (1979), ka studiuar Letërsi të Përgjithshme dhe Teori Letërsie. Ajo është kritike letrare dhe autore tregimesh të cilat janë publikuar në revista dhe antologji të



Jasna Dimitrijevic

çka ndodhi sa isha në gjumë

terroristët sulmuar brukselin e bagdadin
bota ndryshoi
bota mbeti e njëjtë
dikush vdiq e dikush u lind
miqtë më braktisën
erdhën sejmënët
disa morrën vesh që i tradhtova
disa morrën vesh që s'vlej të humbin kohë
me mua
erdhën faturat e ujit të telefonit të internetit
në frigorifer u prish djathtë
një diktator u lajmërua nga lokacioni i sigurte
mijëra njerëz vrapuan mas pokemonëve

e unë po rri kot
e ngathet
e palënduar
e panevojshme

çka kam n' duar

dy deciltra ujë t'ftohtë për me u zgju
një palë çorapë të lame
filxhanin e palamë ku e mbushi edhe një kafë
lapsin dhe letren për porosi
çelësin dhe syzet
dorezën n'dalje
ma shumë s'mundem me mbajt
krejt të ljerat ma të mëdha se këto

e nëse më mpiket muskuli

nëse mas një ndeshjeje t'randësishme
mas vllëzimit a vrapimit mas fatit
muskuli për njëherë nalet
kam me e fërkur derisa të zbutet
kam me e ledhatur
kam me i tregu përralla
kam me u frikësua
e nëse edhe atëherë nuk e ndij puls
kam me e qitë n'dritare
që me zbrilë zgjitje
me e çukit e me e nduke
që macet me e rrokullisë n'oborr
që gentë me e grupu mas shtëpisë
me e dënu

botuara të rajonit tonë dhe Evropës (Liceulice, Pouëak o nizovima, Booksa, Beton, Ulaznica, Zarez, Bele'nica, Novi kaos, Arteist, Urbani vraeëvi, Litteratura, Lichtungen). Tregimet e Jasna Dimitrijeviç janë shpallur fitues në konkurse të ndryshme të prozës së shkurtër (në Vranac, Bele'nica, Ulaznica, ndërkohë që libri i saj me tregime "Prepoznavanja" (Recognitions, 2015) u botua pasi u shpall fitues i vendit të parë në konkursin e krijimtarisë në dorëshkrim, organizuar nga Biblioteka "Karlo Bijelicki" (Sombor), si dhe u përzgjedh në shortlist-ën e librave më të mirë që konkurronin për çmimin kombëtar "Biljana Jovanoviç" dhe "Dušan Vasiljev" (2015). Prej këtej libri u bë fitues i çmimit "Mirko Kovae" për shkrimtarët e rinj (në hapësirën e ish- Jugosllavisë). Jasna Dimitrijeviç është bashkëorganizatore e konkursit të parë "Biber", mbi tregimin më të mirë shkruar rreth temës së pajtimit, konkurs i organizuar për tregimet e shkruara në gjuhën shqipe, maqedonase, boshnjake, malazeze, kroate dhe serbe. Ajo është bashkëhartuese e përmbledhjes shumëgjuhëshe me tregime të zgjedhura. Qëndrimi i saj në Rezidencën letrare "POETIKA - Tirana in Between", u mbështet nga rrjeti evropian për letërsinë dhe librat - TRADUKI, në të cilin marrin pjesë Austria, Bosnje-Hercegovina, Bullgaria, Gjermania, Kosova, Kroacia, Lihntshajni, Mali i Zi, Maqedonia, Rumania, Serbia, Sllovenia, Shqipëria dhe Zvicra.

derisa t'zgjohet
derisa t'përgjigjet
kam me e shiku botën në sy
kam me e pyet veten a ka ndryshu diçka
kam me kuptu se kurrja ja s'ka ndryshu
kam me u këny n'anën t'jetër
kam me u ba thuasje kurrë s'e kam pasë


ku me e çu kartolinën

mbase në atë adresë ku e kam tavolinën me pajisje shkollore
me pasaportën e parë dhe emna t'skallitun
përfjetësisht n'drrasë
ku vij për pushime verore
me lujt letra e me e shajt pushtelin
apo në adresën e spitalit n'dritaret e s'cillit
gratë n'korniza ia tregojnë boles shamtë
pembe dhe mavi
apo në adresën e shkollës me g'shtenja
n'oborr
dhe me hymjen në anën e gaburme
e vonohemi edhe kur mbërrimë me kohë
apo me e lanë dikush në park
ndërmjet bankes dhe çesmes
ku i gjuanim duqat e parë
apo në adresën e sh'pise n'cep t'qytetit
ku një plakë
me xhemper jeshil e me çorapë të thuruna
me shami t'arnume n'kokë dhe me kaçik
njëgjatë
po vdes n'këtë moment
fillikaj vete
këvehe të fundit u përmend veç për
kokëfortesi
apo aje ku s'asht ma kurrkush
se unë jam n'rrugë
apo n'atë adresë në atë ndërtesë me portretin
e aktorit të ndërje
me fasadën socialistë
te vendi për heronjtë
ku asnjëherë nuk kam hy
por mrenda zemra po m'rrahë
dhe e pyes veten qysh po ndihet
njimend
ku të shkon mendja kur luhua
shkruaj sh'pisë

*Përktheu nga origjinali serbisht
Qerim Ondoz

L

LETËRSIA



Një mesazhi i rëndësishëm i librit është se kalimi nga një gjendje zhvillimi në një tjetër, bëhet sipas etapave të caktuara dhe nga e cila asnjë vend nuk bën përjashtim. Kymesazh është veçanërisht i rëndësishëm për vendet në zhvillim, të cilët për të hyrë në erën e teknologjisë, jo vetëm si konsumatorë, por edhe si prodhues të saj, duhet të kalojnë nëpër ato faza që kanë ecur edhe vendet e zhvilluara dhe për autorin të parat janë fabrikat.

Evolucioni i kombeve

NGA DR. VALBONA NATHANAILI

Ruchir Sharma vjen për herë të parë në gjuhën shqipe, por me një libër të mrekullueshëm dhe shumë të veçantë. Me një përvojë të gjatë si investitor dhe akoma më të gjatë si kontributor me opinione e artikuj të ndryshëm për shumë revista e gazeta prestigjioze, synimi i autorit është të na shpjegojë, nëpërmjet ilustrimeve e fakteve me shtrirje në kohë dhe hapësirë, se evolucionin e kombeve bëhet nëpërmjet cikleve, me ulje e ngritje, me periudha begatie dhe periudha të vështira financiare ekonomike, një lloj si treni në kodrinat argëtuese ruse, por që në rastin e kombeve mund dimensionin argëtues kur cikli ekonomik i radhës është ai i rënies, ose edhe i krizës financiare. Sipas autorit, çdo gjendje ekonomike, veçanërisht ato që karakterizohen nga një boom ekonomik, nuk mund të zgjasë për periudha shumë të gjata kohore. Për ta pasur lexuesit të lehtë parafytyrimin, gjendja e një boomi ekonomik mund të përshkruhet si gjendje me ekuilibër të paqëndrueshëm, për shembull një objekt që e kemi ngjitur në majën e një mali të lartë, të cilin edhe forca më e lehtë e nxjerr nga kjo gjendje dhe në të cilën mund të kthehet përsëri vetëm nën veprimin e forcave me efekt krejtësisht të kundërt.

Për këtë, është shumë e rëndësishme të jemi të ndërgjegjshëm për forcat që i ushqejnë dhe ato që i frenojnë ngritjet dhe rëniet ekonomike, për politikën që duhet të hartojmë e zbatojmë, për faturat që duhet të paguajmë. Dhe të parashikojmë! Por Sharma sugjeron, se saktësia e parashikimit, në këtë botë që duket se më shumë se globalizimi, karakterizohet nga deglobalizimi, nuk mund të shkojë përtej një periudhe kohore më të gjatë se dhjetë vjeçare.

Gjatë gjithë librit, merren në konsideratë, paralelisht, vendet e zhvilluara dhe vendet në zhvil-

lim, ku në të parat, falë demokracisë së konsoliduar, një rol të rëndësishëm në kohështrirjen e një cikli ekonomik luajnë bankat, ndërsa në të dytat, për shkak të një demokracie më shumë se të brishtë, këtë rol e marrin shpesh politikanët, sepse në përgjithësi bankat janë në varësi të tyre, ndërsa vetë drejtuesit, sikundër shprehet autori, pjesën më të madhe të kohës qëndrojnë me telefon në vesh për të zbatuar direktivat që japin këta politikanë, shpesh të korruptuar, populistë a që vegjetojnë në pushtet për shumë mandate me radhë.

Larg statistikave të vështira, shifrave të panumërta dhe indekseve të kota, të cilat Sharma në pjesën më të madhe i kritikon si të manipulueshme, në mos të korruptuara nga fuqia e parasë dhe e njehtësisht të tyre nga pozitat e të bërit biznes, libri është një apel për të kuptuar lojën që luhet në kurriz të begatisë së popullit nga një klasë e korruptuar politikaneve që përpigjen të zgjasin me çdo kusht pushtetin e tyre politik dhe që e shndërrojnë edhe në ekonomik. Sharma përdor konceptin e miliardërëve të mirë dhe të këqij dhe liston si arsye kryesore mënyrën se si këta miliard-

Skeda
Ngritja dhe rënia e kombeve. Forcat e ndryshimit në botën paskrizë.
Autor RUCHIR SHARMA
Përktheu nga anglishtja Valbona Nathanailli
Shtëpia Botuese "Pema", Prishtinë,
qershor 2017

erë e kanë bërë pasurinë, ku vija ndarese është kontributi që japin në progresin e vendit, apo shfrytëzimi i pasurive të tij falë lidhjeve familjare apo korruptive me drejtuesit politikë të radhës.

Sipas Sharmës, mënyra më e mirë për të analizuar gjendjen ekonomike të një vendi është të fillosh duke analizuar se si sillen vendasit dhe të dëgjosh perspektivën e tyre. Në periudha para dhe

➔ **Vijon në faqen 22**

R

ROMAN


Romani "Angelus Novus" (Botimet Toena, 2005) sapo qarkulloi në spanjisht nga Shtëpia Botuese Siruela, një nga më të prestigjiozet e këtij vendi, me përkthim të María Rocés González dhe parathënien e Bernardo Atxaga. Ky roman është botuar dhe ka qarkulluar në vitin 2010 edhe në gjuhën rumune me përkthimin e Kopi Kyçykt. "Angelus Novus", sjellë nga "TOENA" ka qenë më parë finalist në konkurrimin për çmimin "Balkanika 2007" dhe një prej rrëfimeve të përfshirë në të është botuar edhe si libër më vete në Francë me titullin "Gracka". Disa muaj më parë romani "Fjalor udhëzues për misterin e dosjeve" të shkrimtarit Bashkim Shehu meritoi Çmimin Kombëtar në Letërsi. Gjatë muajit prill qarkulloi në frëngjisht romanit i tij "Loja, shembja e qiellit". Ndërsa, në vjeshtën e 2016 u botua në Spanjë libri me korrespondencën e shkrimtarit Bashkim Shehu me Bernardo Atxaga, libër që përcoll me një parathënie nga shkrimtari Amos Oz.

NGA BERNARDO ATXAGA

Për ta karakterizuar këtë libër, nuk ka metaforë më të mirë se sa ajo që përdor vetë autori në një nga faqet e tij, kur flet për copat e një pasqyre që vështrohen pjerrtas dhe japin e marrin mes tyre duke përfutur një labirint pasqyrimesh. Lexuesi nuk do të pendohet po të hyjë në këtë hapësirë: peizazhet, në saje të stilit të shtruar e të saktë të Bashkim Shehur dhe gjithashtu në saje të endjes së përkthimit nga María Rocés González, janë përherë magjepsës; veprë dhe rezultat i një mrekullie. Sepse mrekulli është kur, ndonëse temat, faktet, jetët e rrëfyera janë të tmerrshme, mbresa që mbetet në shpirtin e lexuesit është e shndritshme.

Pjesët e pasqyrës, copat e ndryshme, vërtiten vazhdimisht, faqe mbas faqeje, si elemente të një kaleidoskopi ose të një fuge, dhe nga të gjitha pamjet që na shfaqen në to ndoshta më të qartat janë ato të burgut të Burrelit, në Shqipëri, dhe ato të dy të burgosurve që kaluan atje vitet e fundit, vitet e shumta të fundit të diktaturës së Enver Hoxhës: vetë autori, Bashkim Shehu, dhe bashkëbiseduesi i tij kryesor, Mark Gjoka, i quajtur gjithashtu Mark Shpendi. Janë pjesë me një thellësi të madhe biografike, bar-tëse detajesh që mund të njihen vetëm nëpërmjet përvijës, sikurse shkronja R që u takonte të ridënuarve, apo si ato gaxhat në mure, të cilat, pasi ishin vënë djegur, gjatë luftës, për kafshët e barrës të ushtrisë, tani përdoreshin si elemente shtesë torture për të dënuarit në qelitë e izolimit: lidhur në to, duke mos mundur të rrinë as në këmbë, as ulur, të burgosurit e ndëshkues duhej të kalonin javë të tëra në një pozicion çnjerëzor, të kundërtat njëshëm.

Nëse është e vërtetë, siç thotë Josep Pla, se letërsia u drejtohet shqisave dhe se një fjali si "vinte era dafinë" vlen më shumë se çdo shpjegim abstrakt, ato pjesë të labirintit, copat e pasqyrës që sjellin skena dhe fakte, "jashtësitë" e asaj



çka rrëfehët, ndoshta janë gjëja më e afërt me këtë konceptim të letërsisë, me rrëfimin e kulluar. Nga dora e Bashkim Shehut – e theksoj: dorë përherë e shtruar dhe e saktë, – lexuesi ndjen që ndodhet në burgun e Burrelit, ose që ndodhet në Tiranë, gjatë një ndajmzug, duke u përpjekur të kujtojë fytyrën e një vajze që ka njohur në një mbrëmje vallëzimi.

Por, kujdes, pjesët e pasqyrës që na sjellin vende dhe peizazhe të caktuar zhdunë dhe lexuesi gjendet papritur brenda labirintit. Tabloja bëhet më komplekse, pamjet e pasqyrës pasojnë njëra-tjetrën dhe shumohen. Burgu i Burrelit, përveç qenies së tij konkrete, është një *imago mundi*, shëmbëlltë e botës, dhe veç asaj është edhe Ferri; Mark Gjoka, Mark Shpendi, si në një portret të mbivendosur; është, ose duket sikur është Walter

Benjamin-i; të dy ndonjëherë ngatërrohen me vetë Bashkim Shehun. Në këto faqe, irrfimi bëhet më i ndërlikuar dhe kthehet kaq filozofia.

Prania e Walter Benjamin-it pushton labirintin. Gjithçka duket se shpie tek ai, dhe për të bëjnë fjalë bisedat e Bashkimit me mikun e tij Markun në oborrin e burgut, dhe refleksionet dhe kronikat që, si një shëmbëllim shtesë në pasqyrë, burrojnë prej tyre. Tema themelore është ajo që, në mënyrë emblematike, Walter Benjamin-i e zbuloi duke u nisur nga tabloja e Paul Klees-ë *Angelus Novus*. Bashkimi ia thotë përmbledhtas Markut, sipas kujtesës, duke cituar fragmente përgjysmë, gjatë një ecejake në oborrin e burgut të Burrelit:

Për Walter Benjamin-in, shëmbëlltëra e paraqitur në këtë tablo është engjëlli i historisë, i shtyrë gjithmonë lart dhe përpara nga një forcë e padukshme ashtu si erërat, por me fytyrën gjithmonë të kthyer mbrapa, drejt së shkuarës, dhe duke vështruar përposhtë pirgjet e gërmadhave të kohërave të mocme e të reja, grumbuj që sa vijnë e zmadhohen.

Angelus Novus përmendet në fragmentin e dorëshkrimit që kishite me vetë Walter Benjamin-in kur u vetëvra në Portbou duke u ikur trupave hitleriane. Në të shprehur në mënyrë poetike teza e tij mbi historinë, e cila, siç e thekson Juan José Sánchez në parathënieën për librin e Theodor W. Adorno-s dhe Max Horkheimer-it *Dialektika e Iluminizimit*, nuk e vështron historinë si një varg ngjarjesh, po si një katastrofë të vetme. Tashmë



Bashkim Shehu

është e pamundur të besosh në utopitë.

Kur labirinti i pasqyrave i mishëruar në të shkruarit e Bashkim Shehut arrin te kjo pikë, gjithçka errësohet. Ishte gjë e pritshme që utopitë e vjetra, si ajo e *Qytetit të Diellit* të Campanella-s, të dësh-tonin dhe të mos realizoheshin asnjëherë, ngaqë tekefundit nuk ishin gjë tjetër veçse për-ralla; por që, përpos tyre, të dësh-tonin ajo lëvizje emancipuese që kish filluar me Iluminizimin dhe me Enciklopedinë, domethënë, që Epoka e Arsyës të mos kishte tjetër fund përveç barbarisë, kjo ishte shumë e vështirë për t'u pranuar. Po realiteti është kokëfortë: për Walter Benjamin-in, Gjermania naziste, Franca kolaboracioniste, Spanja frankiste; për Bashkimin, për Markun dhe për të gjithë të burgosurit e Shqipërisë

së Enver Hoxhës, një regjim totalitar që dikur, pothuajse gjatë gjithë shekullit XX, ka qenë utopia kryesore, ajo komuniste. Në roman, ndoshta së bashku me kujtimin e gaxhave të qelive ndëshkimore, me e errëta e copave të pasqyrës është ajo ku mbivendoset vetëvrasja e Walter Benjamin-it me vetëvrasjet e disave prej të burgosurve të Burrelit, midis tyre edhe njeriu të cilit i kushtohet ky libër, Mustafa Bajraktari.

Në të mbaruar të një debati radiofonik të transmetuar nga radioja berlizeze SFB më 1965, Arnold Gehlen-i e qorton Theodor W. Adorno-n për pesimizëm dhe i vë në dukje rrezikun që "t'i bëjë të pakënaqur njerëzit për ato pak gjëra që u ka mbetur në situatën katastrofike ku ndodhen". Miku dhe botuesi i Walter Benjamin-it iu përgjigj: "Mirë pra, do të doja ta mbyllja duke cituar një sentencë të Grabbe-s: 'E po asgjë përveç dëshpërimit nuk mund të na shpëtojë'". Po e risjell këtë thënie – që e njoha falë përkthimit nga Toni Domenech – ngase mund të kishte qenë përgjigja që, si një copë e fundit ish-in gjë tjetër veçse për-ralla; por që, përpos tyre, të dësh-tonin ajo lëvizje emancipuese që kish filluar me Iluminizimin dhe me Enciklopedinë, domethënë, që Epoka e Arsyës të mos kishte tjetër fund përveç barbarisë, kjo ishte shumë e vështirë për t'u pranuar. Po realiteti është kokëfortë: për Walter Benjamin-in, Gjermania naziste, Franca kolaboracioniste, Spanja frankiste; për Bashkimin, për Markun dhe për të gjithë të burgosurit e Shqipërisë

NGA DR. VALBONA NATHANALI

→ Vizion nga faqja 21

pas krizë, garën ndërmjet të huajve dhe vendasve e fitojnë gjithmonë vendasit, sepse përpos nuhatjes, janë ata që përballen direkt me pasojat e politikave ekonomike në jetën e përditshme, ndërkohë që të huajt i mbështesin vendimet e tyre kryesisht në të dhënat për vendin, të cilat në rastin më të mirë nuk janë të përditësuar. Por të fituar dalin në përgjithësi të huajt, falë paketave ekonomike subvencionuese që ofrojnë qeveritë në përpjekje për të zbutur pasojat e krizës dhe për të mos trembur investitorët e huaj.

Një mesazhi i rëndësishëm i librit është se kallimi nga një gjendje zhvillimi në një tjetër, bëhet sipas etapave të caktuara dhe nga e cila asnjë vend nuk bën përjashtim. Ky mesazh është veçanërisht i rëndësishëm për vendet në zhvillim, të cilët për të hyrë në erën e teknologjisë, jo vetëm si konsumatorë, por edhe si prodhues të saj, duhet të kalojnë nëpër po ato faza që kanë ecur edhe vendet e zhvil-

luara dhe për autorin *Të parat janë fabrikat*.

Libri merr në analizë disa nga krizat financiare më të fuqishme që kanë goditur botën në këto dekadat e fundit, me një fokus të

veçantë në atë të vitit 2008. Për secilin rast, duke filluar nga Kina, Rusia, Turqia, Brazili, mrekullitë financiare aziatike, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe shumë vende të Europës Lindore, autori

vlerëson kushtet para dhe pas krizës dhe nxjerr konkluzionet. Debito-mania, inflacioni dhe deflacioni i monedhës, fluksi hyrës dhe dalës i kapitalit, eksporti, ekonomi prodhimi apo ekonomi shfrytëzimi e eksportesh të pa-surive natyrore janë koncepte që shtjellohen vazhdimisht nga autori, me një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme për të gjithë. Është një leksion i shkëlqyer për ekonominë dhe zhvillimin, të cilat i janë hequr ekuacionet, po i është shtuar dimensionin social dhe i përgjegjshmërisë që duhet të tregojmë për progresin e vendit.

Autori ndërthur talentin rrëfimtari të ngjarjeve në kohën e sotme, falë punës si gazetar, me shpirtin praktik dhe mendjen kalkuluese të një investitori që i vlerëson ngjarjet në kohën e ardhme, gjë që e bën leximin të thjeshtë, të kuptuarin të thellë dhe horizontin e lexuesit më të gjerë.

RRETH AUTORIT

Ruchir Sharma është drejtues i tregjeve në zhvillim dhe kryetar për strategjinë globale pranë *Morgan Stanley Investment Management*, me më shumë se 20 miliardë dollarë asete nën menaxhim. Sharma udhëton shumë dhe ka kalon, kryesisht, një javë për çdo muaj, në një shtet të ndryshëm, ku takohet e bisedon me drejtues të politikës, drejtues ekzekutivë të kompanive të mëdha, si dhe me personazhe a figura të rëndësishme të vendit.

Sharma ka filluar të shkruajë shumë më shpejt se të bëhet edhe investitor. Artikujt e tij shfaqen shpesh në rubrikën Op-Ed të *Wall Street Journal*,

Financial Times dhe *Times of India*. Kontribuan me ese në revistat *Foreign Affairs*, *Time*, *New York Times*, *Foreign Policy*, *Forbes* dhe *Bloomberg View*.

Në pjesën më të madhe të viteve të dekadës së kaluar ka kontribuar me artikuj editorialë pranë *Newsweek*, ku kishte një rubrikë të rregullt me titull "Global Investor." Libri i tij i parë, *Përtej pritshmërive të kombit: në kërkim të mrekullisë tjetër ekonomike*, u shndërrua shumë shpejt në librin më të shitur në Indi, librin më të shitur për *Wall Street Journal* dhe u zgjodh nga *Foreign Policy* si një nga 21 librat që duhen lexuar, për vitin 2012.

Për *Bloomberg*, në tetor të vitit 2015, Sharma është një nga 20 njerëzit më me influencë në botë. Në vitin 2012, zgjidhet si një nga *Top Global Thinkers* nga *Foreign Policy*, ndërsa në janar të vitit 2013, revista javore, *Outlook*, botim i një stafi të zgjedhur në Indi, e cilëson si një nga 25 njerëzit indianë më të zgjuar në botë. Sipas *World Economic Forum* të Davos, për vitin 2007, Sharma është cilësuar si një nga *Top Young Leaders*.

I pëlqen të marrë pjesë, në mënyrë të vazhdueshme, në gara vrapimi. Stërvitet rregullisht nga një ish-trajner olimpik dhe konkurrion në garat pranverore të vrapimit.